

## NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

**Titulli :** Konsultim publik për paketën fiskale dhe projekt buxhetin e vitit 2024-2026.

**Propozuesi i projektaktit:** Kryetari i Bashkisë.

**Qëllimi:** Ky bashkëbisedim me banorët, grupet e synuara të interesit dhe ato të marginalizuara të Bashkisë Rrogozhinë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me ndryshimet apo propozimet për ndryshime të paketës fiskale dhe projekt buxhetin e vitit 2024 -2026.

**Sqarime:** Konsultimi publik në lidhje me projekt buxhetin e vitit 2024 -2026 bazohet mbi të dhënat e raportit të performancës për vitin 2022 si dhe rekomandimet e marra nga pyetësi i zhvilluar on line për tavanet buxhetore 2024-2026.

**Kalendari i konsultimit:** Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në ambientet e **sallës së Këshillit Bashkiak, ish godina e Bashkisë Rrogozhinë, në datë 22/11/2022, ora 11:00.**

Gjithashtu, sugjerimet e tyre janë të mirëpritura deri më datë 30 Nentor 2023, në adresën e emailit:

[visi.shera85@gmail.com](mailto:visi.shera85@gmail.com)

**Pjesëmarrës:**

- **Nga ana e Bashkisë:** Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Kryetar i Bashkisë, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Koordinator i Njoftimit dhe Konsultimit Publik, drejtues/punonjës të administratës, drejtoria e buxhetit dhe financës, sektori i tatim taksave, Kryetarët e Fshatrave dhe Administratorët e Njësive Administrative.
- **Nga komuniteti:** Banorët e Bashkisë Rrogozhinë, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, gjimnazet, mësuesit, grupe të ndryshme të interesit apo grupet e marginalizuara, etj.

**Forma e konsultimit:** Takim në terren.

|  |  |
|--|--|
| Qëllimi i këshillimit publik   | Konsultimi publik në terren synon konsultimin e paketës fiskale dhe projekt buxhetit të vitit 2024 -2026.  |
| Përshkrimi i çështjes.   | Miratimi i draftit të paketës fiskale dhe projekt buxhetit është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton taksat dhe tarifatat si dhe fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë. Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të organizojë këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi paketën fiskale dhe draftin e buxhetit të vitit 2024-2026. |
| Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve; | Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit të sekretarisë së Këshillit Bashkiak dhe Koordinatorit për Konsultimin me Publikun, <b>BRENDA DATËS 30 Nentor 2023.</b><br><a href="mailto:visi.shera85@gmail.com">visi.shera85@gmail.com</a>   |

|  |  |
|--|--|
|  | <b>Adresa: Këshilli i Bashkisë, ish Godina e Bashkisë Rogozhinë, kati 2.</b>   |
| Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme  | Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit :<br>Ndryshime taksat dhe tarifat ne paketën fiskale si dhe në alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.  |
| Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerren Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit | Dërgimi i sugjerimeve të komunitetit do të jetë i mundur deri në <b>30 Nentor 2023</b> , nëpërmjet adresës së emailit:<br><a href="mailto:visi.shera85@gmail.com">visi.shera85@gmail.com</a><br>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje;</li> <li>2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, taksave dhe tarifave dhe çdo këshilltari të bashkisë;</li> <li>3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës, taksave dhe tarifave (<b>mbledhja e komisionit është e hapur për publikun</b>) të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë;</li> <li>4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të paketës fiskale dhe projekt buxhetit vjetor;</li> <li>5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në <b>seancën e hapur</b> të Mbledhjes së Këshillit;</li> <li>6. <b>Informimi i komunitetit</b>, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre;</li> <li>7. <b>Publikimi</b> i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit;</li> <li>8. <b>Njoftimi</b> i administratës për aktin e miratuar;</li> <li>9. <b>Monitorimi</b> i zbatimit të tij.</li> </ol> |
| Data e publikimit  | <b>16.10.2023</b>  |